




	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU KOSOVO COMPETITION AUTHORITY	
Nr.i Prot./Br. Prot./Prot.No.	553/23 - 12/0
Nr.i Fq./Br. St./No.Pg.	1/5
Date/Datum/Date	20.11.2023
Republika e Kosovës	
Republika Kosovo - Republic of Kosovo	
Autoriteti i Konkurrencës	
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority	



Nr.101/2023

Datë 20.11.2023

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 26, nenit 27, nenit 35, nenit 36 paragrafi 6 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 08/L-056 bazuar në iniciativën e paraqitur nga Rrjeti i organizatave joqeveritare Avonet kundër Kryqit të Kuq të Kosovës në lidhje me kufizimin e konkurrencës, në mbledhjen e mbajtur me datën 20.11.2023 merr këtë:

## K O N K L U Z I O N

Me të cilën konstaton se Autoriteti i Konkurrencës, pas shqyrtimit dhe vlerësimit paraprak të situatës në tregun përkatës, nuk ka kushte për të filluar procedurën ndaj Kryqit të Kuq të Kosovës sipas nenit 36 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 08/L-056.

## A r s y e t i m

### Iniciativa për fillimin e procedurës:

Autoriteti i Konkurrencës me datë 07.07.2023, ka pranuar ankesë/kërkesë urgjente për hetim në lidhje me kufizimin e konkurrencës nga Kryqi i kuq i Kosovës, lidhur me disa pretendime të shkeljes së konkurrencës në kuadër të disa veprimeve të Kryqit të kuq.

Sipas palës ankuese, Avonet shpreh shqetësimin e shumë qytetarëve në lidhje me kryerjen e pagesave për kryerjen e trajnimit të ndihmës së parë për kandidatët për patent shofer, këto pagesa në vlerë prej 15.00 Euro mund të kryhen vetëm në subjektin bankar NLB dhe në asnjë institucion bankar apo financiar tjetër. Gjithashtu për kryerjen e kësaj pagesë qytetarët po detyrohen të paguajnë një shumë aspak racionale në vlerë prej 2.50 euro, në emër të provizonit bankar. Me këto veprime po shkelet neni 10 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përcakton Republikën e Kosovës si ekonomi e tregut me konkurrencë të lirë dhe gjithashtu këto veprime po bëhen shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Pretendim tjetër i palës ankuese është se Kryqi i Kuq i Kosovës po bën shkelje indirekte të ligjit në fjalë përmes organizimin ose thënë ndryshe marrjen e monopolit për organizimin e trajnimit të ndihmës së parë për shoferë të automjeteve, me këtë veprim po kufizohet konkurenca e lirë e garantuar përmes akteve juridike në Republikën e Kosovës.

### **Pretendimet e palës ankuese:**

Ojqi Avonet shpreh shqetësimin e shumë qytetarëve në lidhje me kryerjen e pagesave për kryerjen e trajnimit të ndihmës së parë për kandidatët për patent shofer, këto pagesa në vlerë prej 15.00 Euro mund të kryhen vetëm në subjektin bankar NLB dhe në asnjë institucion bankar apo financiar tjetër. Gjithashtu për kryerjen e kësaj pagesë qytetarët po detyrohen të paguajnë një shumë aspak racionale në vlerë prej 2.50 euro, në emër të provizonit bankar. Me këto veprime po shkelet neni 10 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përcakton Republikën e Kosovës si ekonomi e tregut me konkurrencë të lirë dhe gjithashtu këto veprime po bëhen shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Po ashtu, bazuar në informacionet e Avonet, kemi vënë re se kjo situatë dhe praktikë e krijuar ku subjekti i vetëm që ofron trajnim për ndihmën e parë në lidhje me kandidatët për patent shofer është Kryqi i Kuq i Kosovës dhe pagesën për këtë trajnim mund të e bëjmë vetëm në subjektin bankar Banka NLB. Kjo situatë dhe praktikë po krijon një kufizim të ndjeshëm të konkurrencës, duke penguar hyrjen dhe konkurrimin e organizatave të tjera jo-qëveritare apo edhe institucioneve të tjera bankare, financiare dhe mikrofinanciare në tregun e lirë të Republikës së Kosovës.

Dyshojmë se me këto veprime institucionet në fjalë kanë bërë shkelje të nenit 5 të Ligjit nr 08/L-056 Për Mbrojtjen e konkurrencës, dhe në gjykimin tonë ekziston dyshimi i arsyeshëm se ekziston marrëveshje e ndaluar (Kartel), në mes të palëve. Ne besojmë se kjo marrëveshje e ndaluar midis Kryqit të Kuq të Kosovës dhe institucioneve shtetërore që e udhëheq trajnimin e ndihmës së parë po shkel dispozitat themelore të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Këtë dyshim e mbështesim në nenin 5 të Ligjit, i cili ndalon marrëveshjet që kufizojnë konkurrencën në mënyrë të pakonkurrueshme.

Pretendim tjetër i palës ankuese është se Kryqi i Kuq i Kosovës po bën shkelje indirekte të ligjit në fjalë përmes organizimin ose thënë ndryshe marrjen e monopolit për organizimin e trajnimit të ndihmës së parë për shoferë të automjeteve, me këtë veprim po kufizohet konkurenca e lirë e garantuar përmes akteve juridike në Republikën e Kosovës. Kërkojmë nga Autoriteti i Konkurrencës, të ndërhyjë dhe të zhvillojë një hetim të hollësishëm në lidhje me këtë cështje. Hetimi duhet të konsiderojë se si kjo marrëveshje e ndaluar midis Kryqit të Kuq të Kosovës dhe institucioneve shtetërore po pengon hyrjen e organizatave të tjera jo-qeverituare, bankare, financiare dhe mikrofinanciare në tregun e zhvillimit të trajnimit të ndihmës së parë dhe po kufizojnë konkurrencës e lirë duke ja pamundësuar pagesën e këtij trajnimi në banka, institucione financiare dhe mikrofinanciare tjera por vetëm në subjektin NLB.

Po ashtu me datë 28.09.2023, pranë Autoritetit për Mbrojtjen e Konkurrencës, ka arritur edhe një dokument nga Avonet, përmes të cilit kërkohet që Autoriteti i Konkurrencës të lëshoj mendim profesional – Rekomandim dhe që të konkludoj që marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Postë Telekomunikacionit dhe Kryqit të Kuq të Kosovës, e vitit 2002 kufizon konkurrencën duke ju pamundësuar subjekteve të tjera që të konkurrojnë përmes thirrijeve publike apo procedurave tjera të parapara me ligjet pozitive në Republikën e Kosovës për organizimin e trajnimit të ndihmës së parë për procedurat e pajisjes me patentë shofer nga MPB. Është kërkuar nga Autoriteti që të konsiderojë se kjo marrëveshje kufizon skajshmërisht konkurrencën e lirë në Republikën e Kosovës dhe që Autoriteti të sygjeron që të shfuqizohet

nga MMPhi-ja. Po ashtu, është kërkuar nga AVONET që Autoriteti të vlerojë se neni 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 dhe 1.7 i ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës kufizon konkurrencën e lirë të garantuar sipas Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Arsyet e këtyre kërkeseve përqendrohen sepse me këtë marrëveshje MMPhi-ja ka përfshirur në terti procedurat e Ligjit të Prokurimit Publik të cilat garantojnë konkurrencë të lirë dhe mundësi për ofertim për shërbimet e trajnimit në fjalë.

### **Aktivitetet e zhvilluara gjat shqyrtimin paraprak**

Autoriteti i Konkurrencës ka zhvilluar takim me zyrtar nga Kryqi i Kuq i Kosovës për të trajtuar ankesën e rrjetit të OJQ-ve Avonet, dhe për të kuptuar më mirë rrëth ligjit për kryqin e kuq të Republikës së Kosovës.

Zyrtarët nga Kryqi i Kuq i Republikës së Kosovës, kanë përmendur ligjin për kryqin e kuq të Republikës së Kosovës, ligj i cili rregullon statusin, veprimtarinë dhe burimet financiare të Kryqit të Kuq të Kosovës.

Kryqi i Kuq i Kosovës është e vetmja Shoqatë Kombëtare e Kryqit të Kuq në Kosovë, e cila zhvillon aktivitetin e vet humanitar, vullnetar, jofitimprurës në terti territorin e Kosovës. Kryqi i Kuq i Kosovës përbush misionin e vet në bazë të Parimeve Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Institucionet Qeveritare në çdo kohë dhe rrëthanë duhet të respektojnë zbatimin e Parimeve Themelore të Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe nga Kryqi i Kuq i Kosovës sipas rezolutës 55/I të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të adoptuar me 19 Nëntor 1946.

Për realizimin e detyrave dhe obligimeve të përcaktuara më këtë ligj, Kryqi i Kuq i Kosovës siguron mjete financiare nga: Anëtarësimi në kryqin e kuq të Kosovës, veprimtaritë për realizimin e të cilave Republika e Kosovës, personat fizik dhe juridik ia besojnë Kryqit të Kuq të Kosovës, të hyrat nga realizimet e programeve të kontraktuara me marrëveshje të bashkëpunimit me ministritë përkatëse, aktivitetet tradicionale, donacionet nga personat fizik dhe juridik, të ardhurat nga pronat e patundshmëritë e Kryqit të Kuq etj. Mjetet e grumbulluara në të holla në bazë të këtij ligji, deponohen në llogarinë bankare të Kryqit të Kuq të Kosovës. Të gjitha këto mjete përdoren për zhvillimin e programeve me qëllime humanitare në përputhje me Parimet themelorë të lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Po ashtu, në bazë të neni 16 të ligjit për Kryqin e kuq, Qeveria e Republikës së Kosovës i siguron mjete Kryqit të Kuq të Kosovës, që të veprojë si ndihmëse në sferën humanitare për përbushjen e detyrave sipas nenit 10 të këtij ligji.

Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për Kryqin e Kuq e bëjnë ministritë përkatëse në pajtim me kompetencat e tyre.

Zyrtarët e Kryqit të Kuq kanë deklaruar se kanë të hapur vetëm një llogari në NLB, por pagesat mund të kryhen edhe nga institucionet tjera financiare në llogarinë e Kryqit të Kuq të Kosovës. Po ashtu, ata deklaruan se janë në bisedime që pagesat e Kryqit të Kuq të lehtësohen edhe më tepër dhe te ju mundësohet qytetarëve që të bëhen edhe në insitucionet tjera financiare.

### **Shqyrtimi paraprak i tregut relevant dhe korniza ligjore:**

1. Autoriteti i Konkurrencës zhvillimin e procedurës e bazon në nen 35 – Propozimi për Fillimin i Procedurës dhe ex-officio nen 36 - Fillimi i Procedurës, dhe atë në rastet kur kemi të bëjmë me të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ana e ndërmarrjeve që operojnë në tregjet përkatëse. Neni 3 i Ligjit i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës e definon përkufizimin Ndërmarrje sipas të drejtës së konkurrencës, si vijon:

*“Ndërmarrje - çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, i angazhuar në veprimtari ekonomike, pavarësisht statusit juridik dhe mënyrës së financimit. Organi publik quhet ndërmarrje nëse angazhohet në veprimtari ekonomike”.*

Kryqi i Kuq i Kosovës sipas politikës së konkurrencës në rastin konkret bazuar në veprimtarinë e saj, **nuk konsiderohet ndërmarrje** në kuptim të nenit 3 Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, që kryen aktivitet ekonomik dhe si rrjedhojë nuk operon në treg, përmes blerjes së mallrave ose shërbimeve nëse përdorimi pasues i mallrave ose shërbimeve të blera përbën veprimtari ekonomike.
2. Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është ruajtja e procesit konkurrues dhe nxitja e konkurrencës efektive në treg. Ruajtja ose nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme, duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat apo ai shtetëror/publik mund t'i bëjnë konkurrencës. Prandaj ligji i konkurrencës ndalon marrëveshjet përfiksimin e çmimit, abuzimin me fuqinë dominuese, si dhe përqendrimet që rrezikojnë të krijojnë një pozitë dominuese në treg.
3. Ligji Nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës është ndihmëse e autoriteteve vendore për cështje humanitare në mbarë vendin dhe si i tillë gjëzon përkrahjen e Institucioneve qeveritare.
4. Kryqi i Kuq i Kosovës realizon veprimtari humanitare dhe promovon njohuri mbi Lëvizjen e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, edukimin shëndetësor të popullatës, mbrojtjen sociale, respektimin e të drejtës humanitare ndërkombe, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe vlerave humanitare. Kryqi i Kuq i Kosovës ka për detyrë të trajnojë dhe certifikojë ligjëruesit për projektin e Ndihmës së Parë si dhe të bëjë aftësimin dhe certifikimin e kandidatëve për Ndihmën e Parë të cilët aplikojnë për patentë shofer, sipas Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor. Kryqi i Kuq i Kosovës zhvillon veprimtari në pajtim me legjislatacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, Parimet Themelore të Lëvizjes Ndërkombe, të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, Statutin dhe Rregulloret e veta, traktatet Ndërkombe, Rezolutat e dala nga Konferenca Ndërkombe e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe dhe dokumenteve tjera të Lëvizjes Ndërkombe të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.
5. Kur ligjet e sektorit përkatës parashikojnë marrjen e masave të posaçme, si kontrolli i çmimeve ose aksesi në infrastruktura fizike, organet publike/ rregulatorët sektoriale kanë detyrën dhe përgjegjësinë kryesore për të mbikëqyrur këta parametra të konkurrencës.

6. Në sektorët e rregulluar, zbatimi i ligjit të konkurrencës varet nga shkalla e konkurrencës që lejohet në treg. Në parim, nëse ligjet përkatëse fiksojnë parametrat kryesorë të konkurrencës, si çmimin dhe sasinë, duke mos lënë më vend për konkurrencën, ligji për mbrojtjen e konkurrencës nuk do të zbatohet, për arsy se legjislatori ka vendosur që mbrojtja e interesave të tjera publike justifikon uljen e shkallës së konkurrencës.
7. Gjithashtu, ligji formal që rregullon një sektor të caktuar duhet të parashikojë organin kompetent, të shprehë qartë që ky i fundit zotëron një kompetencë për caktimin ose miratimin e çmimeve, si dhe rastet në të cilat caktohet çmimi. Gjithashtu, përcaktohet se ky organ duhet të ushtrojë kompetencën, domethënë duhet të ketë marrë një vendim për rastin konkret. Në rastin konkret provimin nga "Ndihma e parë" realizohet nga subjekti i autorizuar nga Ministria përkatëse për Transport në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.
8. Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrotjtjen e Konkurrencës, u vendos si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.
9. Obligohet Sekretariati që të kujdeset për zbatimin e këtij konkluzioni.
10. Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana Komisionit.

**AUTORITETI I KONKURRENCËS**  
**Komisioni**

**Neime Binaku - Isufi**

Kryetare



**Kaltrina Sela**  
Nënkyetare

**Florent Mehmeti**  
Anëtar

**Nafije Osdautaj**  
Anëtare

**Salihe Gashi Loku**  
Anëtare

**Këshilla juridike:** Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente.

Me këtë KONKLUZION të njoftohen:

- Pala ankuese (Ojq Avonet)
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arhiva